


SA PËRDORET NDËRMJETËSIMI NË VENDIN TONË?

NUMRI I RASTEVE TË REFERUARA PËR NDËRMJETËSIM NGA ORGANET PUBLIKE DHE NUMRI I RASTEVE TË ZGJIDHURA, KU PALË PARAQITEN ORGANET PUBLIKE




Me qëllim të avancimit të konceptit të ndërmjetësimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në muajin korrik 2019 miratoi një Konkluzion që detyron të gjitha organet shtetërore, institucionet, ndërmarrjet publike në pronësi të shtetit, por edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, para se të fillojnë procedura gjyqësore, së pari të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin përmes ndërmjetësimit. Përkundër faktit se sipas të dhënave të anketës¹ ka një rënie të numrit të rasteve të referuara për ndërmjetësim nga institucionet publike dhe numrit të rasteve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit, ku palë paraqiten institucionet publike për vitin 2019, kjo rënie mund të jetë edhe për shkak të numrit të përgjithshëm të mosmarrëveshjeve ku palë janë institucionet publike.

NORMA E SUKSESIT TË MOSMARRËVESHJEVE TREGTARE DHE TË PUNËS, TË ZGJIDHURA PËRMES NDËRMJETËSIMIT




NORMA E SUKSESIT TË MOSMARRËVESHJEVE TREGTARE DHE TË PUNËS, TË ZGJIDHURA PËRMES NDËRMJETËSIMIT NË PERIU DHËN NGA VITI 2016 DERI MË 20 TETOR 2020²

Norma e suksesit të mosmarrëveshjeve tregtare me anë të ndërmjetësimit është 23,3% (nga gjithsej 689 raste, marrëveshje janë arritur për 161 sosh).



Norma e suksesit të mosmarrëveshjeve të punës me anë të ndërmjetësimit është 89,1% (nga gjithsej 1060 raste, marrëveshje janë arritur për 945 sosh).



¹ Të dhënat janë nga një anketë me ndërmjetësues, e kryer nga Instituti për Politikë Evropiane në muajin shkurt të vitit 2020. Anketës iu përgjigjën 22 nga 46 ndërmjetësues.

² Sipas të dhënave të dhëna nga Ministria e Drejtësisë në ngjarjen me rastin e Ditës Evropiane të Drejtësisë, organizuar nga Instituti për Politikë Evropiane (EPI) - Shkup.